- when it has to be **right**

Leica Geosystems AG

# GARANCI NDËRKOMBËTARE E KUFIZUAR

**General**

This International Limited Warranty cannot in any way be regarded as a promise exceeding the statutory warranty provisions pursuant to the Swiss law of obligations (*Obligationenrecht, OR*). Whenever the term Guarantee is used hereinafter, it refers to the warranty rights of a business customer within the framework of a purchase contract. The statutory warranty rights only apply if and insofar as they are not explicitly or implicitly limited or excluded hereinafter.

**Dispozita të Përgjithshme**

Kjo Garanci Ndërkombëtare e Kufizuar në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si një premtim që tejkalon dispozitat ligjore të garancisë në përputhje me ligjin zviceran të detyrimeve (Obligationenrecht, OR). Sa herë që termi Garanci përdoret më poshtë, ai i referohet të drejtave të garancisë së një klienti biznesi brenda kornizës së një kontrate blerjeje. Të drejtat e garancisë ligjore zbatohen vetëm nëse dhe për aq sa nuk janë të kufizuara ose të përjashtuara në mënyrë të qartë ose të nënkuptuar më poshtë.

**Hardware Guarantee Bond**

**In purchase transactions, all statutory warranty claims of the customer are excluded.** Leica Geosystems AG ("Leica Geosystems") guarantees vis-à-vis the original end consumer ("Customer"), pursuant to the International Limited Warranty or insofar as the exclusion of warranty is ineffective, that under normal use, the product will be free from production and material defects for a period of one (1) year, with the exception of (i) DISTO™ products with a guarantee period of two (2) years and (ii) batteries with a guarantee period of ninety (90) days, or longer in case of a corresponding extension of the guarantee period by Leica Geosystems, provided that the operating and maintenance instructions are strictly adhered to, in particular in case of extreme and/or continuous application/use. The guarantee period commences upon the proven purchase date (or, if applicable, the delivery date or the date of the acceptance report). Within the framework of this International Limited Warranty, Leica Geosystems exclusively undertakes, at Leica Geosystem's choice and cost, to replace or repair the defective product or to reimburse the purchase price paid for the product. For repaired or replaced products and/or product parts, Leica Geosystems provides a guarantee for a period of ninety (90) days from the shipment date or until the expiry of the original guarantee period, whichever is the longer period. All replaced products and/or product parts will become the property of Leica Geosystems. This guarantee bond excludes third-party products and consumables such as reflectors, bulbs and fuses. This Guarantee will become invalid if the product is installed, combined or operated with equipment other than the original equipment authorised by Leica Geosystems.

**Detyrimi i Garancisë për Harduerët**

**Në transaksionet e blerjes, janë të përjashtuara të gjitha pretendimet ligjore të garancisë së klientit.** Leica Geosystems AG ("Leica Geosystems") garanton përkundrejt konsumatorit përfundimtar fillestar ("Klienti"), në përputhje me Garancinë Ndërkombëtare të Kufizuar ose për aq sa përjashtimi i garancisë është i paefektshëm, që, me një përdorim normal, produkti do të jetë pa defekte materiale ose të prodhimit për një periudhë prej një (1) viti, me përjashtim të (i) produkteve DISTO™ me një periudhë garancie prej dy (2) vjet dhe (ii) baterive me një periudhë garancie prej nëntëdhjetë (90) ditësh, ose më gjatë në rast të një shtyrjeje përkatëse të periudhës së garancisë nga Leica Geosystems, me kusht që udhëzimet e funksionimit dhe mirëmbajtjes të respektohen në mënyrë rigoroze, veçanërisht në rast të aplikimit/përdorimit ekstrem dhe/ose të vazhdueshëm. Periudha e garancisë fillon me datën e verifikueshme të blerjes (ose, nëse është e zbatueshme, datën e dorëzimit ose datën e raportit të pranimit). Brenda kornizës së Garancisë së këtij Prodhuesi, Leica Geosystems merr përsipër ekskluzivisht, sipas zgjedhjes dhe kostos së Leica Geosystem, të zëvendësojë ose riparojë produktin me defekt ose të rimbursojë çmimin e blerjes së paguar për produktin. Për produktet e riparuara ose të zëvendësuara dhe/ose pjesët e produkteve, Leica Geosystems ofron një garanci për një periudhë nëntëdhjetë (90) ditësh nga data e dërgesës ose deri në skadimin e periudhës fillestare të garancisë, cilado që të jetë periudha më e gjatë. Të gjithë produktet e zëvendësuara dhe/ose pjesët e produkteve do të bëhen pronë e Leica Geosystems. Ky detyrim garancie përjashton produktet e palëve të treta dhe materialet e konsumit, siç janë reflektorët, llambat dhe siguresat. Kjo Garanci do të bëhet e pavlefshme nëse produkti instalohet, kombinohet ose përdoret me pajisje të ndryshme nga pajisjet origjinale të autorizuara nga Leica Geosystems.

**Software Guarantee Bond**

For "System Software" (defined as operating software and/or firmware which is required in order to start and operate the hardware), the scope of the guarantee provided by Leica Geosystems is determined by the guarantee bond for hardware. For "Application Software" (defined as preinstalled or loadable on-board-software and/or Office- or PC-based software for specific product applications and/or data), these guarantee provisions explicitly do not apply. Regarding the scope of the guarantee for Application Software, please refer to the respective software licence agreement.

**Detyrimi i Garancisë për Softuerët**

Për "Softuerin e Sistemit" (i përcaktuar si softuer operativ dhe/ose firmueri që kërkohet për të filluar dhe operuar me harduerin), fusha e garancisë e dhënë nga Leica Geosystems përcaktohet nga detyrimi i garancisë për harduerin. Për "Softuerin e Aplikimit" (i përcaktuar si softuer i parainstaluar ose i ngarkueshëm në bord dhe/ose softuer i bazuar në Office ose PC për aplikime specifike të produkteve dhe/ose të dhëna), këto dispozita të garancisë shprehimisht nuk janë të vlefshme. Për sa i përket fushës së garancisë për Softuerin e Aplikimit, ju lutemi t'i referoheni marrëveshjes përkatëse të licencës së softuerit.

**Assertion of Guarantee Claims**

The Customer must request a Guarantee Claim Approval within the guarantee period, either from the authorised Leica Geosystems dealer or, with the exception of DISTO™ products, from a service centre specified by Leica Geosystems. For this purpose, the Customer must submit a receipt evidencing the date on which the product was purchased from Leica Geosystems or an authorised Leica Geosystems dealer as well as a description of the defect. Leica Geosystems is not obliged to provide any guarantee services for products or product parts which it receives without a Guarantee Claim Approval. The repaired or replaced product and/or product

**Pretendimi i të Drejtave të Garancisë**

Klienti duhet të kërkojë Miratimin e të Drejtave të Garancisë brenda periudhës së garancisë, ose nga tregtari i autorizuar i Leica Geosystems ose, me përjashtim të produkteve DISTO™, nga një qendër shërbimi e specifikuar nga Leica Geosystems. Për këtë qëllim, Klienti duhet të paraqesë një faturë që dëshmon datën në të cilën produkti është blerë nga Leica Geosystems ose një tregtar i autorizuar i Leica Geosystems, si dhe një përshkrim të defektit. Leica Geosystems nuk është e detyruar të ofrojë ndonjë shërbim garancie për produktet ose pjesët e produkteve që merr pa Miratimin e të Drejtave të Garancisë. Produkti dhe/ose pjesa e produktit të riparuar

part will be delivered to the Customer within an appropriate period. The Customer will bear the shipping costs for the repaired or replaced products and/or product parts. Leica Geosystems cannot be held liable for transport damage. Leica Geosystems will determine the place of performance for the guarantee services at its own discretion. For products which form part of a fixed installation, the place of performance will be at the location of the installation and the Customer will be obliged to reimburse Leica Geosystems for the guarantee services if and insofar as the location of the installation is not the same place where the product was originally installed or delivered.

ose zëvendësuar do t'i dorëzohet Klientit brenda një periudhe të përshtatshme. Klienti do të përballojë shpenzimet e transportit për produktet e riparuara ose të zëvendësuara dhe/ose pjesët e produkteve. Leica Geosystems nuk mund të konsiderohet përgjegjëse për dëme të transportit. Leica Geosystems do të përcaktojë vendin e kryerjes së shërbimeve të garancisë sipas gjykimit të saj. Për produktet të cilat janë pjesë e një instalimi fiks, vendi i kryerjes së shërbimit do të jetë në vendin e instalimit dhe Klienti do të jetë i detyruar të rimbursojë Leica Geosystems për shërbimet e garancisë nëse dhe për aq sa vendndodhja e instalimit nuk është i njëjti vend ku produkti ka qenë instaluar ose dorëzuar fillimisht.

**Exclusivity of the Guarantee Bond**

In case of a guarantee event, the Customer's rights are exclusively determined by the above guarantee bond. The aforementioned guarantee bond applies with exclusive effect and replaces all other explicit or implied guarantees, conditions and provisions, whether of an actual or statutory nature, including those referring to the quality customary in the market, suitability for a specified use, satisfactory quality and compliance with third-party rights, any promises regarding trade usage, business transactions and performance history, any promises that the software is compatible with a specific hardware or software, that the software can be adequately used with the Customer's equipment and will not cause any damage to the equipment or data of the Customer and any promises that the operation of the software will be uninterrupted or "error-free", all of which are explicitly excluded.
Leica Geosystems cannot be held liable if the alleged defect was caused by a misuse, negligence, incorrect installation, maintenance, connection or operation of the product with equipment other than the original equipment authorised by Leica Geosystems or insufficient maintenance, non-compliance with operating instructions, unauthorised attempts by the Customer or a third person to open, repair or alter the product, excessive load or strain, normal wear and tear or other reasons beyond the framework of the intended use, or by accident, fire and/or other reasons for which Leica Geosystems is not responsible. This guarantee does not cover physical damage or malfunctions of the product resulting from a use of the product in combination with any additional or peripheral devices where Leica concludes that the product itself was not malfunctioning.

**Ekskluziviteti i Detyrimit të Garancisë**

Në rast të një ngjarjeje objekt garancie, të drejtat e klientit përcaktohen ekskluzivisht nga detyrimi i mësipërm i garancisë. Detyrimi i garancisë si më lart zbatohet me efekt ekskluziv dhe zëvendëson të gjitha garancitë, kushtet dhe dispozitat e tjera të shprehura ose të nënkuptuara, qoftë të një natyre aktuale apo ligjore, përfshirë ato që i referohen cilësisë së zakonshme në treg, përshtatshmërisë për një përdorim specifik, cilësisë së kënaqshme dhe pajtueshmërisë me të drejtat e palëve të treta, premtimeve të mundshme në lidhje me përdorimin për tregti, transaksione biznesi dhe historinë e performancës, premtimeve të mundshme se softueri është i pajtueshëm me një harduer ose softuer specifik, se softueri mund të përdoret në mënyrën e duhur me pajisjet e Klientit dhe nuk do të shkaktojë ndonjë dëm në pajisjet ose të dhënat e Klientit dhe premtimeve të mundshme që funksionimi i softuerit do të jetë i pandërprerë ose "pa gabime", të gjitha këto janë shprehimisht të përjashtuara.
Leica Geosystems nuk mund të konsiderohet përgjegjëse nëse defekti i pretenduar është shkaktuar nga një keqpërdorim, neglizhencë, instalim i pasaktë, mirëmbajtje, lidhje ose funksionim i produktit me pajisje të ndryshme nga pajisjet origjinale të autorizuara nga Leica Geosystems ose një mirëmbajtje e pamjaftueshme, mosrespektim i udhëzimeve të funksionimit, përpjekje të paautorizuara nga Klienti ose një person i tretë për të hapur, riparuar ose modifikuar produktin, një ngarkesë ose sforcim i tepërt, konsumim normal ose shkaqe të tjera përtej kornizës së përdorimit të synuar, ose nga një aksident, zjarr dhe/ose arsye të tjera për të cilat Leica Geosystems nuk është përgjegjëse. Kjo garanci nuk mbulon dëmtimet fizike ose keqfunksionimet e produktit që rezultojnë nga përdorimi i produktit në kombinim me ndonjë pajisje shtesë ose periferike ku Leica arrin në përfundimin se vetë produkti funksiononte mirë.

**Limitation of Liability**

WITHIN THE FRAMEWORK ADMISSIBLE PURSUANT TO APPLICABLE LAW, LEICA GEOSYSTEMS EXCLUDES ALL LIABILITY – IRRESPECTIVE OF WHETHER THIS CONCERNS LIABILITY UNDER CONTRACT, QUASI-CONTRACT OR TORT (INCLUDING SLIGHT AND MEDIUM NEGLIGENCE) – FOR DIRECT, INDIRECT AND SPECIAL DAMAGE, CONSEQUENTIAL DAMAGE, PUNITIVE DAMAGES, BUSINESS LOSSES OF ANY KIND, LOSS OF INFORMATION OR DATA OR OTHER FINANCIAL LOSS RESULTING FROM THE SALE, INSTALLATION, MAINTENANCE, USE, PERFORMANCE, LOSS OR SERVICE INTERRUPTION OF THE PRODUCT OR IN CONNECTION THEREWITH, AND LIMITS ITS LIABILITY AT ITS OWN DISCRETION TO A REPLACEMENT, REPAIR OR REIMBURSEMENT OF THE PURCHASE PRICE. THIS LIMITATION OF LIABILITY APPLIES EVEN IF LEICA GEOSYSTEMS OR ITS AUTHORISED DISTRIBUTION PARTNERS WERE INFORMED ABOUT THE POSSIBILITY THAT SUCH DAMAGE MAY OCCUR. THIS LIMITATION OF LIABILITY WILL NOT BE AFFECTED IF ONE OF THE LEGAL REMEDIES SPECIFIED HEREIN FAILS TO FULFIL ITS PURPOSE. SOME JURISDICTIONS DO NOT ALLOW A LIMITATION OF LIABILITY FOR DIRECT OR INDIRECT DAMAGE SO THAT THIS LIMITATION OF LIABILITY MAY BE INEFFECTIVE. IF THE APPLICABLE LAW DOES NOT ALLOW A COMPLETE EXCLUSION OR A COMPLETE LIMITATION OF LIABILITY REGARDING THE CLAIMS FOR DAMAGES AS LISTED ABOVE, LIABILITY WILL BE LIMITED AS FAR AS LEGALLY PERMISSIBLE. EQUALLY, LIABILITY FOR SUPPORT PERSONNEL IS EXCLUDED AS FAR AS LEGALLY PERMISSIBLE.

**Kufizimi i Përgjegjësisë**

BRENDA KORNIZËS SË PRANUESHME NË PAJTIM ME LIGJIN NË FUQI, LEICA GEOSYSTEMS PËRJASHTOHET NGA TË GJITHA PËRGJEGJËSITË - PAVARËSISHT NËSE KJO KA TË BËJË ME PËRGJEGJËSINË SIPAS KONTRATËS, DRAFT-KONTRATËS OSE SHKELJEN (PËRFSHIRË NEGLIZHENCËN E LEHTË DHE MESATARE) - PËR DËM TË DREJTPËRDREJTË, INDIREKT DHE TË VEÇANTË, DËM PASUES, DËME NDËSHKUESE, HUMBJE TË ÇDO LLOJI NË AKTIVITET, HUMBJE INFORMACIONI OSE TË DHËNASH OSE HUMBJE TJETËR FINANCIARE QË REZULTON NGA SHITJA, INSTALIMI, MIRËMBAJTJA, PËRDORIMI, PERFORMANCA, HUMBJA OSE NDËRPRERJA E SHËRBIMIT TË PRODUKTIT OSE NË LIDHJE ME TË, DHE KUFIZON PËRGJEGJËSINË, SIPAS GJYKIMIT TË SAJ, NË NJË ZËVENDËSIM, RIPARIM OSE RIMBURSIM TË ÇMIMIT TË BLERJES. KY KUFIZIM I PËRGJEGJËSISË ËSHTË I VLEFSHËM EDHE NËSE LEICA GEOSYSTEMS OSE PARTNERËT E SAJ TË AUTORIZUAR TË SHPËRNDARJES KANË QENË TË INFORMUAR NË LIDHJE ME MUNDËSINË QË NJË DËM I TILLË TË NDODHË. KY KUFIZIM I PËRGJEGJËSISË NUK DO TË PREKET NËSE NJË NGA MJETET JURIDIKE TË SPECIFIKUARA KËTU NUK ARRIN TË PËRMBUSHË QËLLIMIN E TIJ. DISA JURIDIKSIONE NUK LEJOJNË NJË KUFIZIM TË PËRGJEGJËSISË PËR DËMIN DIREKT OSE INDIREKT KËSHTU QË KY KUFIZIM I PËRGJEGJËSISË MUND TË JETË I PAEFEKTSHËM. NËSE LIGJI I ZBATUESHËM NUK LEJON NJË PËRJASHTIM TË PLOTË OSE NJË KUFIZIM TË PLOTË TË PËRGJEGJËSISË NË LIDHJE ME PRETENDIMET PËR DËMET E RENDITURA MË SIPËR, PËRGJEGJËSIA DO TË KUFIZOHET SIPAS LIGJIT. NË TË NJËJTËN MËNYRË, PËRGJEGJËSIA PËR PERSONELIN NDIHMËS PËRJASHTOHET NË PËRPUTHJE ME KUADRIN LIGJOR.

**Limitation**

Should a court not allow the complete exclusion or the limitation of the implied guarantees or of the liability for indirect or consequential damage for certain products delivered to consumers or the limitation of liability for bodily harm, these implied guarantees and these types of liability will be limited to the duration of the guarantee bond.

**Kufizimi**

Nëse një gjykatë nuk lejon përjashtimin e plotë ose kufizimin e garancive të nënkuptuara ose të përgjegjësisë për dëme indirekte ose pasuese për produkte të caktuara të dorëzuara tek konsumatorët ose kufizimin e përgjegjësisë për lëndim të njerëzve, këto garanci të nënkuptuara dhe këto lloje të përgjegjësisë do të kufizohen deri në kohëzgjatjen e detyrimit të garancisë.

**Severability Clause**

Should a competent authority deem a provision of this International Limited Warranty void, ineffective or unenforceable, the respective provision will be regarded as deleted from this International Limited Warranty while the remaining provisions of this International Limited Warranty will remain in full force and effect. In this case, the International Limited Warranty will be interpreted and, if necessary, amended in order to achieve or approximate a result which comes as close as possible to the result intended by the provision regarded as void, ineffective or unenforceable.

**Klauzola e Ndarjes**

Nëse një autoritet kompetent gjykon se një dispozitë e Garancisë së këtij Prodhuesi është e pavlefshme, joefektive ose e pazbatueshme, dispozita përkatëse do të konsiderohet e fshirë nga Garancia e këtij Prodhuesi ndërsa dispozitat e mbetura të Garancisë së këtij Prodhuesi do të mbeten në fuqi dhe me efekt të plotë. Në këtë rast, Garancia e Prodhuesit do të interpretohet dhe, nëse është e nevojshme, do të ndryshohet në mënyrë që të arrihet një rezultat i plotë ose sa më afër rezultatit të synuar nga dispozita e konsideruar si e pavlefshme, joefektive ose e pazbatueshme.

**Third Party Beneficiary**

Leica Geosystems AG hereby explicitly confirms that this International Limited Warranty also covers subsidiaries of Leica Geosystems including the entity from which the Customer purchased the product. Customers are therefore entitled to assert the same claims against the subsidiary which sold them a product or a service as they could against Leica Geosystems AG. Without prejudice to of the aforesaid, the same defence rights and objections which are available to Leica Geosystems AG within the framework of this International Limited Warranty are also available to such subsidiaries.

**Pala e Tretë Përfituese**

Leica Geosystems AG me anë të kësaj konfirmon në mënyrë të qartë se kjo Garanci Ndërkombëtare e Kufizuar gjithashtu mbulon filialet e Leica Geosystems duke përfshirë entitetin nga i cili Klienti ka blerë produktin. Për këtë arsye, klientët kanë të drejtë të paraqesin të njëjtat pretendime kundër filialit që u ka shitur atyre një produkt ose një shërbim, siç mund të bënin kundër Leica Geosystems AG. Pa paragjykuar sa më sipër, të njëjtat të drejta dhe kundërshtime të mbrojtjes që gëzon Leica Geosystems AG në kuadër të kësaj Garancie Ndërkombëtare të Kufizuar gëzohen gjithashtu edhe nga filialet e tilla.

**Governing Law and Jurisdiction**

This International Limited Warranty is governed by Swiss law, excluding the United Nations Convention on Contracts for the International Sale of Goods of 11 April 1980. The ordinary courts at Leica Geosystems AG registered place of business in Switzerland, have jurisdiction. At its own discretion, Leica Geosystems is also entitled to address the ordinary courts at the Customer's place of business/residence.
With this International Limited Warranty, Leica Geosystems grants the Customer specific rights. This does not limit any statutory consumer rights.

**Ligji i Zbatueshëm dhe Juridiksioni**

Kjo Garanci Ndërkombëtare e Kufizuar rregullohet nga ligji Zviceran, duke përjashtuar Konventën e Kombeve të Bashkuara për Kontratat për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave të 11 prill 1980. Gjykatat e zakonshme në vendin ku Leica Geosystems AG ka regjistruar aktivitetin e saj në Zvicër, kanë juridiksion. Sipas dëshirës së saj, Leica Geosystems gjithashtu ka të drejtë t'u drejtohet gjykatave të zakonshme në vendin e aktivitetit/vendbanimit të Klientit.
Me këtë Garanci të Prodhuesit, Leica Geosystems i jep Klientit të drejta specifike. Kjo nuk kufizon asnjë të drejtë ligjore të konsumatorit.

**Governing Language**

Any other language translation is provided as a convenience only. In the case of any inconsistency or discrepancy between original English texts and their translation into any other language, as the case may be, original versions in English shall prevail. Governing Language. This agreement is written in English.

**Gjuha e Zbatueshme**

Çdo përkthim në gjuhë tjetër jepet vetëm si lehtësim. Në rast të ndonjë parregullsie ose mospërputhjeje midis teksteve origjinale angleze dhe përkthimit të tyre në ndonjë gjuhë tjetër, sipas rastit, versionet origjinale në anglisht do të mbizotërojnë. Gjuha e Zbatueshme. Kjo Marrëveshje është shkruar në anglisht.

Leica Geosystems AG
Heinrich-Wild-Straße 201
CH-9435 Heerbrugg
(Zvicër)
www.leica-geosystems.com